Trashëgima – Burim i Pashtershëm Zhvillimi

Newsletter 1 - 2014

Raport për veprimtarinë e Fondacionit "Gjirokastra" gjatë vitit 2013

KALENDARI I VITIT 2013 – Aktivitete më të rëndësishme

-**Në prill** u përurua përfundimi i restaurimit të ndërtesës Babameto dhe fillimi i rijetëzimit të saj përmes krijimit të Qendrës për Trashëgimi dhe Kulturë "Babameto". Projekti u zbatua në bashkëpunim me organizatën Trashëgimi Kulturore pa Kufij, që ishte kontribuesi kryesor.

-**Në fund të tetorit** përfundoi me sukses projekti 2-vjeçar shumë kompleks REVATO (Rijetëzimi në qytetet historike Berat dhe Gjirokastër), i dyti projekt që Fondacioni "Gjirokastra" zbaton në 3 vitet e fundit me mbështetjen e drejtpërdrejt nga Komisioni Europian.

-Si çdo vit, **në fund të shtatorit**, në rrugët e kalldrëmta të Pazarit të Gjirokastrës, u zhvillua Panairi Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Artizanatit, i cili u mbështet nga UN Women. Panairi i vjetshëm u pasurua më tej në përmbajtje dhe aktivitete, duke u konfirmuar si eventi më i rëndësishëm kulturor dhe turistik për Gjirokastrën; njëkohësisht dhe aktiviteti më i rëndësishëm në shkallë kombëtare që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme për artizanatin në Shqipëri.

- **Në dhjetor** në vazhdim të Panairit, në Tiranë, Fondacioni Gjirokastra organizoi për herë të parë Ankandin me Produktet më të mira Artizanale të Vitit, zhvilluar pas një trajnimi 2 mujor me 3 artizane nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, mbështetur nga UN Women.

- **Në nëntor** përfundoi projekti "Nga Plehra në Vlera" për riciklimin në prodhimin artizanal i mbështetur nga Partners Albania. Projekti u zhvillua në ndërtesën e restauruar Babameto 2 në Pazarin e Gjirokastrës duke kontribuar në rijetëzimin e saj.

Më konkretisht me projektet e zbatuara nga Fondacioni Gjirokastra gjatë viti 2013, mund të njiheni në vazhdim:

REVATO: vlerat e Trashëgimisë takohen me vlerat dhe potencialet e tregut (http://revato.info)

Projekti REVATO – Rijetëzimi në Qytetet Historike të Beratit dhe Gjirokastrës u zhvillua për dy vjet në të dy qytetet shqiptare të UNESCO-s dhe është projekti më kompleks që Fondacioni "Gjirokastra' ka zbatuar në 12 vjet të veprimtarisë së tij. Ky projekt kompleks, i dyti i financuar nga Komisioni Europian për Fondacionin Gjirokastra, ka sjellë një pasurim të jashtëzakonshëm të përvojës së Fondacionit Gjirokastra si në aspektin e menaxhimit dhe administrimit përmes partneritetit publik privat, ashtu edhe në organizimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe me institucionet publike etj.

REVATO identifikoi ndërhyrjet dhe ndërtimet pa kriter dhe pamjaftueshmërinë e theksuar të investimeve në fushën e konservimit dhe restaurimeve si probleme themelore të gjendjes shqetësuese në menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore (TK) në Shqipëri. Projekti adresoi tre nga problemet kryesore që pengojnë përmirësimin e gjendjes:

Problemi I. **Mosregjistrimi kadastral i Trashëgimisë Kulturore** (TK) dhe paqartësia e pronësisë private të saj, që shkakton mospërfshirjen e TK e investimeve private për ruajtjen, rijetëzimin dhe përdorimin e ndërtimeve historike.

Duke adresuar këtë problem REVATO

a.-**Krijoi një databazë për ndërtimet Monument Kulture në Berat dhe Gjirokastër dhe evidentoi gjendjen e regjistrimit të tyre si pasuri e paluajtshme**. Kjo database, së bashku me kompjuterët përkatës i është dorëzuar Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) dhe DRKK-ve përkatëse, Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (Tiranë, Berat dhe Gjirokastër) si dhe drejtorive përkatëse të Arkivit të Shtetit. Për grumbullimin e të dhënave u punua me arkivat shtetërore dhe të bankave, si dhe u intervistuan shtëpi më shtëpi banorët në rreth 1000 Monumente Kulture të kategorisë së parë dhe të dytë që kanë Berati dhe Gjirokastra. Rezultatet janë në një regjistër on line http://computerwizard-al.com/revato/front/index, që është efektiv në përdorim të kontrolluar nga IMK në shërbim të pronarëve dhe investitorëve të mundshëm.

b.- **Siguroi asistence ligjore për më shumë se 280 qytetarë në Berat dhe Gjirokastër në procesin e regjistrimit të pronës së tyre,** përmes një firme ligjore. U realizuan falas për qytetarë dhjetëra seanca këshillimi juridik, 58 plane rilevimi, 50 akte noteriale, 140 dosje u plotësuan përcollën për aplikim/regjistrim në zyrat ZRPP dhe institucione të tjera përgjegjëse etj.

Konkluzionet e kësaj përvoje u përmblodhën në **një studim me problemet e ndërlikuara në këtë fushë dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre**.

c.-Për të parën herë në vend u realizua **në shkallë masive vlerësimi si pasuri e paluajtshme i më shumë se 250 pronave monumente kulture.** Vlerësimi u krye nga dy kompani me eksperiencë në tregun ndërkombëtar, gjë që ndihmon investimet private në to. Çmimet minimale dhe maksimale për Beratin janë 200-1000 €/m² dhe për Gjirokastrën 200-900€/m².

d.- U përgatitën **10 modele biznes-planesh** për të demonstruar praktikisht se si në ndërtimet historike mund të zhvillohen aktivitete ekonomike, që sigurojnë njëkohësisht rijetëzimin dhe ruajtjen e ndërtesave monument kulture. Këto janë modele që mund të zbatohen nga qytetarët, bizneset dhe bankat.

Problemi II**. Ndërgjegjësimin i ulët publik dhe anashkalimi i rolit të qytetarit** në procesin e ruajtjes dhe menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore i shprehur në mungesën e Partneritetit Publik-Privat (PPP)

Problemi III**. Mungesa e transparencës dhe në vendimmarrjen e menaxhimit** të Trashëgimisë Kulturore.
Duke adresuar këto probleme REVATO:

a. **krijoi një shoqatë me pjesëmarrjen e qytetarëve të të dy qyteteve**, e cila u trajnua teorikisht dhe krijoi një përvojë të mirë veprimi në terren, duke u aktivizuar në gjithë veprimtarinë dy vjeçare për zbatimin e projektit REVATO. Shoqata, që mban po ashtu emrin REVATO synon të zhvillojë më tej frymën e projektit që e krijoi, duke përfaqësuar interesat shumë specifike të shtresës së pronarëve të trashëgimisë kulturore. Shoqata është regjistruar dhe ka filluar veprimtarinë e saj edhe në projekte të ndryshme.

b. **organizoi një fushatë mediatike** dhe aktivitete të hapura me pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe i kontaktoi ata duke trokitur derë më derë në 1000 familje.

c. përmes një **procesi krejtësisht transparent dhe publik angazhoi qytetarët drejtpërdrejt në restaurimin e çative të 11 ndërtimeve monument kulture** në të dyja qytetet, duke u mbështetur në partneritetin publik-privat. Çatitë u përzgjodhën përmes një votimi të hapur dhe të drejtpërdrejtë bazuar në vlerat e banesave historike, si dhe interesimin për mirëmbajtje dhe kontributin në restaurim të vetë pronarëve të tyre. Një qytetar në Gjirokastër e krahasoi këtë proces të hapur dhe publik me votimin në Festivalin Europian të Këngës. Restaurimet u kryen me sukses duke dhënë një impakt pozitiv në qytet dhe duke nxitur banorët të ruajnë dhe zhvillojnë pronat e tyre. Shembull për këtë është banesa Kokalari në Gjirokastër, ku familja po zhvillon nisma të saj për rijetëzimin e banesës së tyre.

Nga takimet e hapura në Berat - Qytetari Vendos

Nga restaurimet në të dy qytetet

Konferenca përmbyllëse e projektit,
22 tetor 2013, Tiranë

Qendra Babameto: një model i rijetëzimit të Trashëgimisë Kulturore përmes investimeve zhvillimore

Restaurimi i shtëpisë Babameto një nga më kryesorët në Pazarin e Gjirokastrës u përurua me 6 prill 2013. Pas vitesh braktisjeje dhe rrënimi kjo ndërtesë, si edhe ndërtesa tjetër Babameto 2 janë restauruar në standarde shumë të mira dhe pajisur siç duhet. Ato krijojnë së bashku Qendrën për Kulturë dhe Trashëgimi "Babameto", e cila ofron hapësira për trajnime, aktivitete kulturore, aktivitete në mbështetje të zhvillimit të turizmit si mësim të gatimeve tradicionale lokale, valleve popullore dhe këngës polifonike etj. Një aktivitet tipik për këtë qendër ishte kampi ndërkombëtar dyjavor i restaurimit, i organizuar nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij në muajin shtator, ku mjediset e QB shërbyen për akomodimin e pjesëmarrësve, punishte për punët praktike, për aktivitete dëfrimi etj. Qendra shërben edhe si hostel kur nuk ka aktivitet të këtij lloji. Për më shumë http://hostelbabameto.beep.com/index.htm.

Rijetëzimi i dy ndërtesave Babameto u bë përmes një projekti disavjeçar të ndërmarrë nga organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) dhe Fondacionit Gjirokastra. I gjithë projekti, që nga konceptimi përfshiu aktivisht trashëgimtarët e familjes dhe synon të demonstrojë në praktikë se vetëm rijetëzimi në bashkëpunim të domosdoshëm me pronarët, mund të sjellë shpëtimin për ndërtesat historike në Gjirokastër.

Shtëpia Babameto është monumenti i gjashtë i rëndësishëm që Fondacioni "Gjirokastra" restauron dhe rijetëzon në bashkëpunim dhe bashkëfinancim edhe me partnerë të tjerë gjatë 12 viteve të aktivitetit të tij, krahas disa restaurimeve të rëndësishme të hapësirave publike.

Panairi Kombëtar i Artizanatit në ndihmë të zhvillimit të tregut dhe produkteve artizanale - tri elemente të reja në Panairin e Shtatë

Në fundjavën e fundit të shtatorit 2013, në kalldrëmet e Pazarit të Gjirokastrës u zhvillua Panairi i 7-të Kombëtar i Artizanatit dhe Trashëgimisë Kulturore.

Panairi zhvillohet rregullisht në ditët e Trashëgimisë Kulturore – fundshtatori dhe mbështetet nga Bashkia e Gjirokastrës. Ai është tashmë eventi më i rëndësishëm i rregullt që zhvillohet në mbështetje të artizanatit në Shqipëri. Në Panairin e 7-të morën pjesë më se 100 artizanë që përfaqësojnë rreth 130 prodhues nga e gjithë Shqipëria në të gjithë gamën dhe llojet e ndryshme të artizanatit, duke përfshirë punimet tradicionale shtëpiake: (qëndisma, qilima) punime të gurit, mozaikë, prodhime në kashtë, aplikacione në lloje të ndryshme të metalit, drurit etj.

Panairi është edhe një event kulturor dhe turistik me rëndësi për qytetin e Gjirokastrës. Në tre ditët e zhvillimit të tij u përuruan 2 ekspozita në pikturë dhe artizanat, u zhvillua konkurrimi i gatimeve më të mira tradicionale gjirokastrite, u organizuan 2 tryeza të rrumbullakëta - për rritjen e rolit të gruas në sipërmarrjen e bizneseve të vogla të artizanatit dhe aplikimin e riciklimit në artizanat , u përuruan dy dokumentarë kushtuar artizanatit etj.

Panairet Kombëtare të Artizanatit në Gjirokastër janë pjesë e programit shtatë vjeçar të Fondacionit "Gjirokastra" për zhvillimin e artizanatit në kuadrin e përpjekjeve që janë bërë e po bëhen për rijetëzimin e Pazarit karakteristik mesjetar të qytetit. Programi i artizanatit përfshin ringjalljen e zejeve tradicionale, krijimin dhe mbështetja e disa punishteve të prodhimit dhe tregtimit të artizanatit, organizmin e prodhimit dhe restaurimit të kostumeve të mrekullueshme popullore, krijimin e Qendrës së Artizanatit në zemrën e Pazarit karakteristik, duke përfshirë edhe restaurimin për këtë qëllim të një ndërtese të rrënuar dhe braktisur.

Përmasa dhe elemente të reja i dha Panairit mbështetja nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), që, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, mbështeti ardhjen dhe pjesëmarrjen e 50 grave dhe vajzave zejtare. Si rezultat, panairi u zhvillua si një garë mes artizaneve. 3 gra - nga Tirana, Shkodra, Pogradeci - u përzgjodhën për t'u mbështetur dhe trajnuar.

Gjithashtu Qendra Rajonale e Mjedisit - REC Shqipëri, i dha mbështetje panairit përmes projektit SENiOR- A; Partners Albania ndihmoi krijimin e "show room-it" me prodhime artizanale të ricikluara.

Në panairin e shkuar, për herë të parë, u përdorën edhe donacione të vogla të mbledhura nga bizneset dhe banorë të qytetit. Fondacioni Gjirokastra ndërkohë po fillon përgatitjet për gjetjen e fondeve për Panairin e 8-të që do të zhvillohet në Gjirokastër më 26-28 shtator 2014. Kushdo që është i interesuar të kontribuojë është i mirëpritur të na shkruajë në info@gjirokastra.org.

Panairi i Artizanatit udhëton nga Gjirokastra në Tiranë - Ankandi i produkteve artizanale

Në dhjetor, në vazhdim të Panairit, në Tiranë, Fondacioni Gjirokastra organizoi për herë të parë Ankandin me Produktet më të mira Artizanale të Vitit. Në këtë ankand, morën pjesë 3 artizane që dolën si fituese për prodhimet më të mira në Panairin e Gjirokastrës. Ato u trajnuan për 2 muaj nga 2 stiliste të kualifikuara duke sjelle produkte fine të krijuara duke u mbështetur në motivet, teknikat dhe materialet tradicionale. Të ardhurat shtesë që dolën nga Ankandi do të përdoren për organizimin e Panairit Gjirokastra 2014. Fondacioni Gjirokastra mbështeti edhe përfaqësimin e artizanëve gjirokastritë në Panairin e fundvitit në Tiranë organizuar nga Agjencia e Nxitjes së Biznesit Social.

"Nga plehra në vlera" - ricikimi i mbetjeve tesktile dhe plastike në prodhimin artizanal

"Nga Plehra në Vlera" – ishte një nga projektet e suksesshëm të vitit 2013, ku u ndërthur artizanati me mbrojtjen e mjedisit. Projekti u mbështet nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti e ishte ndër tre ftuesit e konkursit kombëtar Ide të Gjelbra 2013, zhvilluar në muajin prill në rang kombëtar.

Mbështetur në traditën e gjatë dhe të frytshme që ka për zhvillimin e artizanatit, Fondacioni Gjirokastra krijoi përmes mbështetjes nga PA një plan biznesi ku prodhimi mbi baza riciklimi sjell dhe të ardhura për gratë të cilat punojnë me metoda tradicionale në qendrën e GjiroArt.

Produktet e realizuara përfshijnë një sërë suveniresh prej tekstili të ricikluar, plastike dhe guri të vizatuar me motive të qytetit të gurtë. Një katalog me punimet më të mira për shitje u publikua në fund të projektit. Projekti 10 mujor u zhvillua në ndërtesën e restauruar së fundmi Babameto 2 e cila u pajis me tezgjahë, makina qepëse.

Ide për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj nisme u prezantuan edhe në një konkurrim për ide të gjelbra dhe zhvillimin e filantropisë në Ballkanin Perëndimor që u mbajt në fund të korrikut 2013.

Fondacioni Gjirokastra pjesë e një rrjeti shërbimesh mjedisore

Gjatë vitit 2013 Fondacioni Gjirokastra është përfshirë edhe në Rrjetin e Shërbimeve Mjedisore, mundësuar nga një grant i REC Albania në kuadër të programit SENiOR-A "Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri", program i financuar nga Qeveria Suedeze.

Në kuadër të rrjetit u mundësua një mbështetje më e gjerë ndaj iniciativës "Nga plehra në vlera" për prodhimin artizanal të suvenireve me material të riciklueshëm. Fondacioni Gjirokastra ndërmori një sërë aktivitetesh për rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët sidomos tek nxënësit e shkollave për mbrojtjen e mjedisit dhe ripërdorimin e materialeve.

Trajnime të realizuara në kuadër të rrjetit dhe programit SENIOR-A ishin të vlefshme për rritjen e kapaciteteve në fushën mjedisore ku përfituan stafi i FGJ dhe specialistë vendas në zonën e Gjirokastrës.
Fondacioni Gjirokastra dhe partnerët e tjerë të rrjetit po bëjnë përpjekje që të vazhdojnë veprimtarinë e tyre edhe në vitet e ardhshme, ku do të synohet formësimi i një zëri të mirëfilltë nga shoqëria civile në adresimin e problemeve mjedisore në rajonin e Gjirokastrës.

"Përtëritja" -një projekt i ri për fuqizimin ekonomik të gruas përmes trajnimit në artizanat dhe hoteleri

"Përtëritja" - është projekti më i ri i Fondacionit Gjirokastra që ka nisur në muajin janar 2014. Projekti, bashkë më 6 të tjera nga zona të ndryshme të vendit është përzgjedhur për t'u mbështetur nga USAID, përmes programit Assist Impact për fuqizimin e gruas.

Projekti synon aftësimin e grave me mundësi të pakta në prodhimet cilësore artizanale dhe turizëm-hoteleri. Synohet që pas periudhës së trajnimeve, që do të mbahen në Qendrën për Trashëgimi dhe Kulturë Babameto, gratë të jenë në gjendje të futen në tregun e punës.

Gjatë prezantimit të 7 organizatave fituese të programit, 28 janar 2014

Për më shumë informacion lutemi shkruani në info@gjirokastra.org
ose telefononi në cel 06920 78767.